

**“INDUSTRIALIMPEKS” SH.A.  
ASAMBLEJA E JASHTËZAKONSHME E AKSIONERËVE**

**VENDIM NR. 1**

**Sot, më dt. 11.06.2004 Asambleja e Jashtëzakonshme e aksionerëve të shoqërisë, me pjesëmarrjen 100% të aksionerëve me të drejtë vote, me unanimitet**

**VENDOSI:**

- **Të zvogëlohet kapitali themeltar i shoqërisë duke u përballuar humbjet e viteve 1999, 2000, 2001 dhe 2002 nga ky kapital.**

**AKSIONERET**

**Për “2K Group” sh.p.k.  
Koço KOKËDHIMA**



**Për Ministrinë e Ekonomisë  
Arvit URUÇI**



**“INDUSTRIALIMPEKS” SH.A.  
ASAMBLEJA E JASHTËZAKONSHME E AKSIONERËVE**

**VENDIM NR. 2**


Sot, më dt. 11.06.2004 Asambleja e Jashtëzakonshme e aksionerëve të shoqërisë, me pjesëmarrjen 100% të aksionerëve me të drejtë vote, me unanimitet

**VENDOSI:**

- Të emërojë z. Et'hem Sula, si ekspert kontabël i autorizuar, për të hartuar raportin e zvogëlimit të kapitalit themeltar të shoqërisë “Industrialimpeks“ sh.a. .

**AKSIONERET**

Për “2K Group” sh.p.k.  
Koço KOKËDHIMA



Për Ministrinë e Ekonomisë  
Arvit URUÇI



**“INDUSTRIALIMPEKS” SH.A.  
ASAMBLEJA E JASHTËZAKONSHME E AKSIONERËVE**

**VENDIM  
Nr. 1 dt. 06.06.2005**

Në Tiranë, sot më dt.06/06/2005, u mbajt mbledhja e Asamblesë së Jashtëzakonshme të Aksionerëve të shoqërisë “Industrialimpeks” sh.a., e cila me unanimitet :

**VENDOSI:**


- 1- Të miratojë raportin e ekspertit kontabël të autorizuar për zvogëlimin e kapitalit të shoqërisë “Industrialimpeks” sh.a. për vlerën e humbjeve të mbartura të viteve 1999, 2000, 2001, 2002 korrigjuar me fitimin e vitit 2003.
  - Kapitali Themeltar i shoqërisë “Industrialimpeks” sh.a., pas pastrimit të humbjeve të vitit 1999, 2000, 2001, 2002 e korrigjuar me fitimin e vitit 2003 është 6.900.000 lekë.
- 2- Zvogëlimi i kapitalit nuk çënon barazinë dhe raportet e aksioneve.
- 3- Ky vendim hyn në fuqi sot, më dt. 06.06.2005.

**Për “Industrialimpeks” sh.a**

**AKSIONERËT**


**Për “2K Group” sh.p.k  
Administratori**

**Koço KOKËDHIMA**



**Për Ministrinë e Ekonomisë  
Përfaqësues me Autorizim**

**Neritan TOTOZANI**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**GJYKATA E SHKALLËS SË PARË TIRANË**  
**NR. 21 534/ 4 AKTI**

**VENDIM**  
**I GJYQITARIT TË VETËM**

Sot, më datë 7/10/2004 (dymijë e katër), unë Enkela Bajo, gjyqtare e Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, pasi mora në shqyrtim kërkesën nr. 727, dt.08.09.2004 të z. Ivzi Rama me cilësinë e drejtorit të shoqërisë "INDUSTRIALIMPEKS" sh.a.,

**KONSTATOVA SE:**

Shoqëria "INDUSTRIALIMPEKS" sh.a është regjistruar si person juridik pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 21534, dt.22.06.1999 dhe ka aksionerë "2K Group" sh.p.k. zotërues i 51% të aksioneve, si dhe Ministrinë e Ekonomisë zotëruese të 49% të aksioneve .

Në dt. 11.06.2004, Asambleja e Jashtëzakonshme e aksionerëve të shoqërisë, me vendimin e saj nr.1 ka vendosur të zvogëlojë kapitalin themeltar të shoqërisë duke u përballuar humbjet e viteve 1999, 2000, 2001, 2002 nga ky kapital, kurse me vendimin nr.2 ka vendosur të emërojë z. Et'hem Sula si ekspertit kontabël të autorizuar për të hartuar raportin e zvogëlimit të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Me vendimin nr.1, dt.11.08.2004, Asambleja e Jashtëzakonshme e aksionerëve të shoqërisë ka vendosur shpërndarjen e fitimit të vitit 2003 prej 5 025 651 lekë, për mbulimin e një pjese të humjes.

Kërkesa është e drejtë dhe e bazuar në ligj.

**PËR KËTO ARSYE:**

Pasi e gjeta të drejtë kërkesën e mësipërme dhe aktet bashkëngjitur asaj, mbështetur në ligjin nr.7638, dt.10/11/1992 "Për shoqëritë tregtare" dhe në ligjin nr.7667, dt. 28/01/1993 "Për rregjistrin tregtar dhe formalitetet që duhen plotësuar nga shoqëritë tregtare",

**VENDOSA:**

1. Pranimin e kërkesës.
2. Depozitimin e :  
- Procesverbalit dt.11.06.2004 mbledhjes së Asamblesë së Jashtëzakonshme të aksionerëve të shoqërisë "INDUSTRIALIMPEKS" sh.a.

- Procesverbalin dt.11.08.2004 të mbledhjes së Asamblesë së Jashtëzakonshme të aksionerëve të shoqërisë “INDUSTRIALIMPEKS” sh.a.
- Vendimet nr.1, 2, dt.11.06.2004 Asamblesë së Jashtëzakonshme të aksionerëve të shoqërisë “INDUSTRIALIMPEKS” sh.a..
- Vendimet nr.1, dt.11.08.2004 të Asamblesë së Jashtëzakonshme të aksionerëve të shoqërisë “INDUSTRIALIMPEKS” sh.a..


3. Urdhërohet zyra e regjistrimit tregtar të bëjë shënimet përkatëse në fletën e regjistrimit tregtar.

Kundër këtij vendimi lejohet ankimi në Gjykatën e Apelit.

Tiranë, më 8/10/ 2004

**GJYQTARE**

**Enkela BAJO**



08.06.2005

# RAPORT

I EKSPERTIT KONTABEL TE AUTORIZUAR

"INDUSTRIAL IMPEKS " SH.A

SHOQERI ANONIME  
TIRANE

RAPORT I EKSPERTIT KONTABEL TE AUTORIZUAR  
I PARASHIKUAR NGA NENET E LIGJIT 7638 DT.19.11.1992  
" PER SHOQERITE TREGETARE " .

TIRANE , ME 05/05/2005

EKSPERT KONTABEL I AUTORIZUAR

HETEM SULAJ



Eksp. Kont. i Autorizuar  
HETEM SULAJ  
TIRANË ALBANIA  
NR. Lic

I E K A  
EKSPERT KONTABEL I AUTORIZUAR  
HETEM SULAJ

PER :

SHOQERIA TREGETARE "INDUSTRIAL IMPEKS" SH. A.  
TIRANE

**RAPORT**

PER ZVOGELIMIN E KAPITALIT THEMELTAR TE SHOQERISE

Me vendim nr. 21534/4 dt. 07.10.2004 te Gjykates se shkalles se pare te rrethit Tirane , jam emeruar ne cilesine e Ekspertit Kontabel te Autorizuar te shoqerise tregetare " Industrial Impeks " sha , Tirane , per vleresimin e kapitalit themeltar te shoqerise duke zvogeluar kapitalin themeltar per mbulimin e humbjeve te akumuluar ne vitet 1999 , 2000 , 2001 , 2002 te korigjuara me fitimin e vitit 2003 .

Ne zbatim te misionit te parashikuar nga neni 164 te ligjit 7638 dt. 19.11.1992 " Per Shoqerite Tregetare " me rastin e zvogelimit te kapitalit , ne ju paraqesim raportin tone mbi projektin e zvogelimit te kapitalit ,

Me shkresen nr. \_\_\_ te prot. Dates 22.05.2004 , shoqeria tregetare "Industrial Impeks " sha Tirane ,ka njoftuar Ministrine e Ekonomise z.Anastas Angjeli ,lidhur me mbajtjen e mbledhjes se Asamblese se Jashtezakonshme te Aksionereve , rendin e dites,daten dhe vendin e mbledhjes.

Me shkresen nr.2649/7 dt.11.06.2004 , autorizohet perfaqsesi I MEP z.Arvit Uruci per te perfaqsuar MEP ne mbledhjen e Asamblese se Jashtezakonshme te Aksionerve te shoqerise tregetare "Industrial Impeks " sha Tirane si dhe qendrimin e MEP si zoteruese e 49% te aksioneve te shoqerise .

Sipas procesverbalit te Asamblese se Jashtezakonshme te Aksionereve te shoqerise tregetare "Industrial Impeks " sha , me daten 11.06.2004 , ne mbledhjen e saj Asambleja e Jashtezakonshme e Aksionerve , me votim unanim , me propozim te drejtorise , eshte shprehur per zvogelimin e kapitalit themeltar te shoqerise nepermjet mbulimit te humbjeve te trasheguara te viteve 1999 , 2000 , 2001 , 2002 pasi te jene korigjuar me fitimin e vitit 2003 , sipas shkrese 3281 dt. 17.05.2004 te MEP te perfaqsuar nga ministri Anastas Angjeli .

Ne perfundim te Mbledhjes se Asamblese se Jashtezakonshme te dates 11.06.2004 , ka dal vendimi nr. 1 dt.11.06.2004 ku eshte vendosur :Te zvogelohet kapitali themeltar I shoqerise duke mbuluar humbjet e viteve 1999 ,2000 , 2001 , 2002 , ndersa me vendim nr. 2 dt . 11.06.2004 Asambleja e Jashtezakonshme e Aksionerve ka vendosur qe Eksperti Kontabel I Autorizuar z. Hetem SULAJ te hartoj raportin lidhur me zvogelimin e kapitalit themeltar te shoqerise .

Me daten 11.08.2004 sipas njoftimit te dates 26.07.2004 , ne seline e aksionerit – shoqerise "2K Group " shpk mbahet mbledhja e Asamblese se Jashtezakonshme te Aksionereve te shoqerise me rend dite :



- Shqyrtimi I propozimit te Ministrise se Ekonomise sipas shkrese nr. 3281 dt. 17.05.2004 drejtuar Asamblese se Jashtezakonshme te Aksionereve te shoqerise.
- Te ndryshme

Me shkresen nr. 4994/2 dt.09.08.2004 te Ministrise se Ekonomise , perfaqsuar nga zv.Ministri Z. Ilir Ciko ( me porosi dhe ne mungese te Ministrit ) autorizohet z. Arvit Uruci qe te marre pjese ne mbledhje si dhe qendrimin qe duhet te mbaje Aksioneri shtet . Ne perfundim te Mbledhjes se Asamblese se Jashtezakonshme te dates 11.08.2004 , ka dal vendimi nr. 1 dt.11.08.2004 ku eshte vendosur :Te perdoret fitimi I vitit 2003 per mbulimin e nje pjese te humbjes .

Sa me siper shoqeria I eshte drejtuar Gjykates se Faktit Tirane , duke depozituar Procesverbalet e te dy Mbledhjeve te Asamblese se Jashtezakonshme se Aksionereve te dates 11.06.2004 dhe te dates 11.08.2004 si dhe te vendimeve te dala nga keto mbledhje nr.1 dhe 2 te dates 11.06.2004 dhe nr.1 te dates 11.08.2004 , dhe Gjykata e shkalles se pare te rrethit Tirane eshte shprehur me vendim nr.21534/4 dt.07.10.2004 , midis te tjerave per zvogelimin e kapitalit . Humbjet e vitit 1999 , 2000 , 2001 , 2002 te korigjuara me fitimin e vitit 2003 , te kalojne ne zvogelim te kapitalit themeltar .Ekspert kontabel I autorizuar per te hartuar raportin e zvogelimit te kapitalit , caktohet z.Hetem Sulaj .

Per realizimin e misionit te mesiperme jane marre ne konsiderate :

1. Shkresa nr.2649/7 dt.11.06.2004 ,Autorizim I perfaqsesit te ME lidhur me qendrimin qe duhet te mbqhet ne mbledhjen e Asamblese se Jashtezakonshme te Aksionereve te shoqerise , te perfaqsesit te Aksionerit Shtet , te Ministrise se Ekonomise.
2. Shkresa nr.4994/2 dt.09.08.2004 , per qendrimin qe duhet te mbahet ne mbledhjen e Asamblese se Jashtezakonshme te Aksionereve ne te perfaqsesit te Aksionerit Shtet , te Ministrise se Ekonomise .
3. Procesverbali I mbledhjes se Asamblese se Jashtezakonshme te Aksionereve te shoqerise “ Industrial Impeks “ sh.a Tirane I dates 11.06.2004 .
4. Vendimi nr.1 dhe 2 dt.11.06.2004 I Asamblese se Jashtezakonshme te Aksionereve te shoqerise “Industrial Impeks “ sh.a Tirane .
5. Procesverbali I mbledhjes se Asamblese se Jashtezakonshme te Aksionereve te shoqerise “ Industrial Impeks “ sh.a Tirane I dates 11.08.2004 .
6. Vendimi nr.1 dt.11.08.2004 I Asamblese se Jashtezakonshme te Aksionereve te shoqerise “Industrial Impeks “ sh.a Tirane .
7. Vendimi I Gjykates se shkalles se pare te rrethit Tirane nr.21534/4 dt.07.10.2004 .
8. Bilanci kontabel te viteve 1999 , 2000 , 2001 , 2002 si dhe bilancin e vitit 2003 se bashku me miratimet e ME dhe me raportet e auditimit , si bilanc I fundit I mbyllur per te pasqyruar veprimet lidhur me zvogelimin e kapitalit themeltar te shoqerise “ Industrial Impeks “ sh.a Tirane.





## VLERESIMI I KAPITALIT THEMELTAR

Ne vleresimin e kapitalit themeltar jemi bazuar ne te dhenat e bilancit financiar te vitit 2002 te ekspertuara nga Eksperti Kontabel I Autorizuar z.Andon Kristo .

## ZVOGELIMI I KAPITALIT THEMELTAR NEPERMJET MBULIMIT TE HUMBJEVE PASI ESHTË KORIGJUAR ME FITIMIN E VITIT 2003.

Pasi jane realizuar humbje gjate ushtrimit te viteve 1999 , 2000 , 2001 , 2002 , situata neto e shoqerise per keto vite paraqitet :

	<u>VITI 1999</u>	<u>VITI 2000</u>	<u>VITI 2001</u>	<u>VITI 2002</u>	<u>VITI 2003</u>
Totali I aktivitet	323.910.257 leke	329.825.858 leke	318.040.824 leke	316.282.022 leke	321.690.445 leke
Detyrimet	290.437.988 leke	296.351.940 leke	310.717.391 leke	310.713.225 leke	311.095.183 leke
<b>Kapitalet e veta</b>	<b>33.472.268 leke</b>	<b>31.895.638 leke</b>	<b>7.323.433 leke</b>	<b>5.568.797 leke</b>	<b>10.595.272 leke</b>
Kapitali themeltar	43.000.000 leke	43.000.000 leke	43.000.000 leke	43.000.000 leke	43.000.000 leke
Diference rivleresimi	1.350.000 leke	1.350.000 leke	1.350.000 leke	1.350.000 leke	1.350.000 leke
Rezerva ligjore	126.886 leke	126.886 leke	126.886 leke	126.886 leke	126.886 leke
Humbje e mbartur	- 13.161.679 leke	- 13.161.679 leke	-14.738.310 leke	-39.310.515 leke	- 41.065.151 leke
Fitim dhe humje te ustrimit	0 leke	- 1.576.631 leke	-24.572.205 leke	- 1.754.636 leke	+ 5.025.651 leke
Fonde te veta (Nd.Shtet)	2.157.062 leke	2.157.062 leke	2.157.062 leke	2.157.062 leke	2.157.052 leke
<b>Shuma kapitale te veta</b>	<b>33.472.268 leke</b>	<b>31.895.638 leke</b>	<b>7.323.433 leke</b>	<b>5.568.797 leke</b>	<b>10.595.272 leke</b>

### A . Efekti zvogelimit tekapitalit themeltar nepermjet pastrimit te humbjeve te vitit 1999 , 2000 , 2001 , 2002 pas korigjimit me fitimin e vitit 2003 :

Humbjet e vitit 1999	- 13.161.679 leke
Humbjet e vitit 2000	- 1.576.631 leke
Humbjet e vitit 2001	- 24.572.205 leke
Humbjet e vitit 2002	- 1.754.636 leke
Fitimi I vitit 2003	+ 5.025.651 leke
<b>Rezultati ( Humbje )</b>	<b>- 36.039.500 leke</b>

### B . Vleresimi I kapitalit themeltar nepermjet pastrimit te humbjeve te vitit 1999 , 2000 , 2001 , 2002 pas korigjimit te tyre me fitimin e vitit 2003 :

Kapitali themeltar	43.000.000 leke
Minus humbjet	- 36.039.500 leke
<b>Diferenca</b>	<b>6.960.500 leke , Kapitali themeltar pas pastrimit te humbjeve te vitit 1999 , 2000 , 2001 , 2002 e korigjuar me fitimin e vitit 2003 .</b>



Veprimet kontabile :

Per humbjet e vitit 1999 , 2000 , 2001 , 2002 e korigjuar me fitimin e vitit 2003 ;

Debitohet llog . 101 Kapitali themeltar per	36.039.500 leke .
Kreditohet llog . 107+121 Fitim dhe Humbje per	36.039.500 leke .

Diferenca midis zvogelimit te kapitalit themeltar nepermjete shumes se humbjes pas korigjimit me fitimin e vitit 2003 dhe kapitalit me shifer te plote , regjistrohet ne llogarine 104 – Prime te lidhura me kapitalin .

Veprimet kontabile :

Debitohet llog . 101 – Kapitali themeltar per	60.500 leke .
Kreditohet llog . 104 – Prime te lidhura me kapitalin per	60.500 leke .

Pas ketyre veprimeve kontabel situata pasqyrohet ;

- Kapitali themeltar me vlere te plote	6.900.000 leke .
- Prime te lidhura me kapitalin	60.500 leke
- Diferenca nga rivleresimi	1.350.000 leke.
- Rezerva ligjore	126.886 leke
- Humbje te akumuluar	0 leke
- <u>Fitimi I vitit ushtrimor</u>	<u>0 leke</u>
- <b>Kapitalet themeltar, rezervat e fitim /humbje</b>	<b>8.437.386 leke</b>
- <u>Fonde te veta ( ndermarje shteterore )</u>	<u>2.157.886 leke</u>
- <b>Kapitalet e veta</b>	<b>10.595.272 leke</b>

Pas zvogelimit te kapitalit themeltar , kapitalet e veta te shoqerise paraqiten si me poshte ;

<b>Kapitalet e veta para projektit te zvogelimit</b>	<b>10.595.272 leke .</b>
<b>Kapitalet e veta pas pastrimit te humbjeve</b>	<b>10.595.272 leke .</b>

#### RAPORTET E ZOTERIMIT TE KAPITALIT THEMELTAR PAS PROJEKTIT TE ZVOGELIMIT

Zvogelimi I kapitalit themeltar nuk cenon barazine dhe raportet e aksionerve e cila ekzistone ne keto raporte ;

- **Ministria e Ekonomise Publike dhe Privatizimit zoteron  $49\% \times 6.900.000=3.381.000$  leke te kapitalit themeltar I cili perbehet nga 3.381 aksione me vlere 1000 lek /aksioni .**

- **2 K GROUP me pronar z. Koco KOKEDHIMA zoteron 51 %x6.900.000 = 3.519.000 leke te kapitalit themeltar I cili perbehet nga 3.519 aksione me vlere 1000 leke/aksioni .**


Ne kemi analizuar operacionet e zvogelimit te kapitalit duke kryer shqyrtimet ( verifikimet ) qe I kemi cmuar te nevojshme sipas normave te profesionit .  
Ne jemi siguruar pikerisht qe zvogelimi nuk con shumen e kapitalit ne shifra posht minimumit te kerkuar nga ligji dhe qe operacioni nuk cenon barazine e aksionerve .

**Ne nuk kemi ndonje verejtje, lidhur me shkaqet dhe kushtet e ketij operacioni I cili do te zvogeloj kapitalin themeltar te shoqerise tuaj nga 43.000.000 leke ne 6.900.000 leke .**

Tirane , me 05/05/2005

EKSPERT KONTABEL I AUTORIZUAR

Hetem SULAJ

  
EKSPERT KONTABEL I AUTORIZUAR  
HETEM SULAJ  
TIRANE ALBANIA  
NR. 100